

V E N D I M
Nr.549, datë 26.8.1996

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, neni 3, të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, neni 54 dhe 56, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

LLOJI I SHËRBIMIT LEKË

1. Lëshimi i certifikatave të pasurisë.(200)
2. Kërkesë për regjistrim të pronësisë të pasurisë së paluajtshme.(50)
3. Kërkesë për regjistrimin e pjesëtimit, ndarjes ose bashkimit të pasurisë së paluajtshme.(100)
4. Kërkesë për konsultim të kartelës dhe të dhënave të tjera të pasurisë së paluajtshme.(50)
5. Kërkesë për kontroll zyrtar të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.(70)
6. Kërkesë për lëshim të kopjes së certifikatës të pasurisë.(300)
7. Kërkesë për saktësimin e kufive.(500)
8. Kërkesë për përgatitjen e dokumentave për në gjykatë ose organ tjetër administrativ.(250)
9. Kërkesë për regjistrim për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje.(150)
- 10.Kërkesë për regjistrim hipoteke, hipoteke ligjore(100)
11. Kërkesë për regjistrim për fshirje hipoteke, hipoteke ligjore.(100)
- 12.Kërkesë për regjistrim për fshirjen e një vendimi të gjykatës, të një akti administrativ.(150)
- 13.Kërkesë për regjistrim servituti, marrëveshje kufizuese. (200)
- 14.Kërkesë për regjistrimin për fshirjen e një servituti, marrëveshje kufizuese. (200)
15. Regjistrimi i kërkesave për heqjen dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme.(150)
16. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi.(200)
- 17.Kërkesë për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasuritë e paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit.(600)
18. Kërkesë për korigjimin e gabimeve materiale në kartelë.(100)
19. Kërkesa për lëshim kopje kartelesh, hartë treguese, ose pjesë të saj.(120)
20. Kërkesë për fotokopje të dokumenteve të pasurive të paluajtshme për

çdo faqe.(10)